

RAPORT MBI VBLERSIMIN E DEMEVE TE SHKAKTUARA NGA VERSHIMET E SHIUT NE KOMUNEN E RAHOVECIT

Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës, nr 01/123/18, të datës 05.03.2018, z. Smajl Latifi, është formuar komisioni vlerësues, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesia natyrore- vershimet e shiut ne komunën e Rahovecit , në përbërje prej:

- 1.Nysret Shala, kryesues
- 2.Nijazi Sokoli, anëtar
- 3.Selim Metkamberi, anëtar

Duke u bazuar ne procesverbale dhe vlerën e dëmeve të shkaktuara nga veshimet e reshjeve të fundit të shiut, komisioni për vlerësimin e dëmeve përpilon këtë raport.

Shtepit e permbytura nga ujrat sipërfaqësor të reshjeve të shiut në fshatin Ratkoc janë:

- **Sanije Morina** ,Ratkoc, vlera e dëmit është 1,450.00 Euro;
- **Neki Morina**,Ratkoc, vlera e dëmit është 2,500.00 Euro.
- **Hamez Morina, Ratkoc** - vlera e dëmit nuk është konstatuar pasi që në bodrumet e shtëpive kishte akoma uj, por sipas deklaratës së palet, i janë dëmtuar disa pajisje elektrike dhe pajisje të nxemjeve qendrore të 4 shtëpive të banimit, përshkak të rrjedhjes së ujit nga gypat e kanalizimit.
- **Samir Vuqiterna** , Rahovec - vlera e dëmit është 1,200.00 Euro,i është permbytur kati përderis nga reshjet e shiut, përshkak të disnivelet që ka shtëpia me kanalin e lumit Dull.
- **Fatmir Krasniqi** , Dejnë - vlera e dëmit është, 2,000.00 Euro, kryesisht i janë dëmtuar inventar shtëpiak si dhe pajisje elektrike, përshkak të disnivelet të shtëpisë me rrugën e fshatit.

Vlen të theksohet se pronarët e këtyre shtëpive, nuk kanë leje ndërtimore dhe nuk i kanë plotësuar kushtet ndërtimore për ndërtimin e objekteve.

- **Samedin Zena** , Radost- Nuk ka dëme të shkaktuara në kulturë bujqësore të paraqitura si në kërkesë, por rrjeti u ujrave të zeza zbrazet në parcelën kadastrale nr 906-0, e cila sipas gjendjes reale në terren nuk është tokë bujqësore por e mbuluar me bimë drusor dhe e permbytur nga rrjedha e lumit Drini i Bardhe.
- **Tokat bujqësore, Celinë** - Sipërfaqet e permbytura me grurë, në tokat bujqësore në mes fshatrave Celinë dhe Fortesë, janë të permbytura disa parcela të mbjellura me grurë dhe në nivelet me të uletat e këtyre parcelave përshkak të sasisë së tepert të ujit për disa ditë me radë ka ngulfatje të bimës dhe dëmet do të jenë evidente.
Fatemiresisht këto toka nuk janë të mbjellura me kulturat bujqësore pasi jemi në fazën e hershme, dëmet do të konsiderohen vonimi i procesit të mbjelljeve e që ky do të jetë zingjir i vonësve deri në produktin final

-

Vlera e dëmeve te shkaktuara nga vershimet

Nr.	Dëmet në:	Objekte/siperfaqe	Vlera
1	Objektet e banimit	7,150.00	7,150.00
2	Tokat Bujqesore	4.7 ha.	3,760.00
	TOTAL		€ 10,910.00

Komisioni vlersues:

- 1.Nysret Shala, kryesues
- 2.Nijazi Sokoli, anëtar
- 3.Selim Metkamberi, anëtar